



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Dragash
Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

01.Nr .060-01-24431/1

Dragash, 26.09.2018

Në bazë të nenit 12, paragrafit 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika b, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 Qershor 2008), neni 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Dragashit, ne seancën e mbajtur më 26.09.2018, morri këtë:

V E N D I M
PER MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT
PËR VITIN 2019 DHE VLERSIMET PËR VITET 2020 DHE 2021

Neni 1.

Miratohet Buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2019 në shumë prej **8,404,652 euro**

Neni 2.

Buxheti i Komunës së Dragashit përbëhet prej mjeteve nga Grantit të Qeverisë të lejuara me Qarkoren Buxhetore 2019/01, dhe atë 2019/2, dhe mjeteve vetanake të planifikuara të komunës të parapara për vitin 2019 dhe atë:

Mjetet nga grantet	7,811,174.00 euro
Huamarrja	92,661.00 euro
Mjetet vetanake	500,817.00 euro

Totali:	8,404,652.00 euro
----------------	--------------------------

Buxheti Sipas Granteve:

Granti i Përgjithshëm	4,089,125.00 euro
Granti i specifik i arsimit	2,702,139.00 euro
Granti specifik i shëndetësisë	1,019,910.00 euro
Huamarrja në arsim dhe shëndetësi	92,661.00 euro
Mjetet vetanake	500,817.00 euro

Totali:	8,404,652.00 euro
----------------	--------------------------

Neni 3.

Të hyrat vetanake në shume prej 500,817.00 euro te planifikuar do te shfrytzojen 10% për subvencione ndersa shuma tjeter prej 90% do te shpenzohen per projekte kapitale.

Neni 4.

Shpërndarja e mjeteve te Buxheti te Komunës se Dragashit, sipas Programeve Buxhetore është:

1.Zyra e Kryetarit	198,000
2. Zyra e K.Komunal	124,940
3 Administrata dhe Personeli	355,000
4 Buxhet Finaca	256,000
5.Sherbimet Publike	158,000
6.Zyra e Komuniteteve	45,120
7.Bujqesi Pylltari dhe Zhvill.rur	126,154
8.Kataster Gjeodezi	56,000
9.Planifikimi Urban	2,312,101
10.Shendetesiadhe Mirq.Sociale	1,153,503
11Sherbimet Sociale	73,000
12.Kultur, rini ,sport	165,200
13. Arsimi dhe Shkenca	3,381,634
Totali	8,404,652

Neni 5.

Në programet buxhetore të prezantuara ne nenin 4. të këtij Vendimi, Sipas Qarkores Buxhetore 2019/2 nga MF-i jane percaktuar: Pagat dhe shtesa **4,568,960.00** euro ,Mallrat dhe sherbimet **868,908.00**,Shpenzimet komunale **130,000** ,subvencionet **50,000.00** dhe shpenzimet kapitale dhe **2,786,784.00** euro,që gjithsejtë bejnë **8,404,652.00** euro.

Neni 6.

Mjetet e tërësishme të parapara nga Neni 1.dhe 2. të këtij Vendimi sistemohen në bilancet e të hyrave dhe të shpenzimeve sipas shfrytëzuesve të përmbledhura ne formën unike ne PCF-3 të prezantuara ne mënyre te veçantë në sistemin e BDMS ,si sistem unik. Sistemimi i këtyre kategorive ne te hyra dhe shpenzime është pjesë përbërëse e këtij Vendimi të prezantuara në format tabelare për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor.

Neni 7.

Numri i punëtorëve për vitin 2019 i percaktuar neper programet buxhetore është limituar në 777 dhe i shperndar sipas tabelës pjese perbese e Vendimit mbi Buxhetin e Komunes se Dragashit per vitin 2019.

Programet buxhetore duhet të sigurojnë që numri i të punësuarëve, asnjëherë, gjatë vitit fiskal 2019 nuk do të tejkalon numërin e përcaktuar me programe buxhetore të limituar me Qarkoren Buxhetore 2019/02 ku është përcaktuar edhe shuma e mjeteve për paga e përcaktuar me Nenin 4. të këtij Vendimi .

Mjetet për Paga të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore 2019/2 në shumë prej 4,568,960.00 euro, nuk plotësojnë në tërësi kërkesën aktuale financiare të numrit të të punësuarëve në programet - nënprogramet buxhetore të komunës së Dragashit. Mungesës e mjeteve për paga për organizatën buxhetore në shumën e përlogaritur prej 15,000 euro (duke patur parasysh numrin e puntorëve të përcaktuar) ,do të kompenzohet gjatë procesit buxhetor në vitin 2019 nga niveli qendror-Qeveria e Kosovës.

Neni 8.

Pozicionet e mjeteve për paga të parapara në formën tabelare PCF-3 janë përcaktuar sipas koeficientëve të paraparë me Rregulloren për të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit, ndërsa për mallëra dhe shërbime dhe shpenzime komunale ,subvencione dhe shpenzime kapitale do të shpenzohen sipas pozicioneve të parapara në pjesën tabelare të buxhetit, që është pjesë përbërëse e këtij Vendimi .

Shpenzimi i këtyre mjeteve do të bëhet pas alokimit të mjeteve në bazë të Planit KESH për vitin 2019 dhe Rregullave të përcaktuara për implementimin e buxhetit për vitin 2019 procedurave normale të mbështetura në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjigjësitë ,Ligjit mbi Prokurimin Publik ,Ligjit mbi Financat Lokale dhe rregulloret tjera në fuqi.

Neni 9.

Mjetet vetanake, si të hyra vetanake të Komunës, të cilat grumbullohen nga tarifat dhe ngarkesat ,tatimi në pronë, dënimet në trafik dhe ngarkesat tjera, si dhe bashkë pagesat për kujdesin primarë shëndetësor janë planifikuar në kordinim me niveli qendror në bazë të ecurive paraprake. Sipas këtyre ecurive, për vitin 2019, planifikohen të grumbullohen mjete në shumë prej 500,817.00 euro.

Grumbullimi, shpërndarja , bartja në BKK , alokimi dhe shfrytëzimi i tyre do të bëhet sipas skemës së paraparë me buxhetin e komunës ,si dhe dispozitave ligjore të Ligjit mbi Buxhetin e R.Kosovës.

Neni 10.

Çdo shfrytëzues i mjeteve të buxhetit (mendohet në Programet Buxhetore të Komunës) ,si të mjeteve vetanake, po ashtu edhe për mjetet nga granti i Qeverisë, duhet të shpenzohen në mbështetje të udhëzimeve në fuqi.

Neni 11.

Shpenzimi i mjeteve për paga, mallëra dhe shpenzime , subvencione dhe shpenzime kapitale do të realizohet në harmoni dhe përputhje me rregullat dhe procedurat, si dhe standardet për hargjimin e mjeteve publike.

Neni 12.

Pasqyrimi si dhe shpërndarja e mjeteve për të gjitha Programet Buxhetore të Komunës, detalisht duken në formën unike tabelare të buxhetit të përfshira në formën tabelare të çdo Programi-nenprogrami buxhetor të bashkangjitur, janë kryekëput bazë e këtij Vendimi. Pjesë e këtij Vendimi është edhe Lista e Projekteve Kapitale (e cila financohet nga të hyrat vetanake dhe Garantet e Qeverisë) të përfshira si Projekte të PIP-të, për periudhën përkatëse.

Neni 13.

Buxheti për vitet 2019-2021 është planifikuar në bazë të Kornizës Buxhetore të R.Kosovës Qarkores buxhetore 2019/01 dhe Qarkores buxhetore 2019/02 ku janë caktuar limetet e kategorive ekonomike buxhetore për buxhetin e komunes Dragashit dhe i njëjti në vitin 2019 në total, është 8,404,652.00 euro, për vitin 2020 vlersimi është 8,752,254.00 euro. Ndërsa vlersimi për vitin 2021 9,116,509.00 euro

Neni 14.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit, implementohet nga: 01.Janari.2019.

A r s y e t i m

Përgatitja e Buxhetit të Komunës së Dragashit, si kërkesë fillestare për vitet 2019-2021, ka filluar qysh në Qershor të vitit 2018. Periudhës përgaditore të këtij Buxheti i kanë paraprirë një numër i madhe i takimeve të organizuar nga Ministria e Financave-i dhe OSBE-ja. Si draft fillestar është prezantuar në 2 dëgjim publik të organizuara nga Kryetari i Komunës dhe ZKF me Anetarët e Asambles. Është shqyrtuar në Bordin e Drejtoreve dhe, në fund, si propozim përfundimtar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa të KK. Dragash. Në bazë të propozimeve të dala nga dëgjimet publike, propozimet nga Bordi i Drejtoreve, si dhe propozimet dhe sugjerimet e Komitetit për Politikë dhe Financa është hartuar Propozimi Final i këtij dokumenti i cili do të miratohet në Kuvendin Komunal, në seancën e mbajtur më: 26.09.2018

Kryesusi i Kuvendit

Betim Mediu



KOMUNA E DRAGASHIT PLANI I NDARJEVE BUXHETORE 2019						Tabela 4:3		
Programet-Nen.		Stafi	Pagat	M&SH	Shp.Komunale	Subvencionet	SH.Kapitale	Totali
Z.Kryetrit	Totali	14	128,000	20,000	0	50,000	0	198,000
160-16009	Granti	14	128,000	20,000				148,000
	TV					50,000		50,000
Administra	Totali	36	180,000	100,000	0	0	75,000	355,000
163-16309	Granti	36	180,000	100,000			75,000	355,000
	TV							0
Z.Kuvendit	Totali	1	107,940	17,000	0	0	0	124,940
169-16909	Granti	1	107,940	17,000				124,940
	TV							0
Ekonomi-Finac	Totali	18	103,000	93,000	60,000	0	0	256,000
175-17509	Granti	18	103,000	93,000	60,000			256,000
	TV							0
SH.Publike	Totali	22	135,000	20,000	3,000	0	0	158,000
180-18413	Granti	22	135,000	20,000	3,000			158,000
	TV							0
ZLK	Totali	5	33,120	12,000	0	0	0	45,120
195-19545	Granti	5	33,120	12,000				45,120
	TV							0
Bujqsi Pylltari	Totali	20	111,154	15,000	0	0	0	126,154
470-47009	Granti	20	111,154	15,000				126,154
	TV							0
Kataster Gjeod	Totali	9	50,000	6,000	0	0	0	56,000
650-65045	Granti	9	50,000	6,000				56,000
	TV							0
PL/Urban Mjed	Totali	8	53,000	6,000	0	0	2,253,101	2,312,101
660-66350	Granti	8	53,000	6,000			1,862,284	1,921,284
	TV						390,817	390,817
SH.M.Sociale	Totali	104	725,000	258,267	30,000	0	140,236	1,153,503
730	Granti	104	725,000	176,674	30,000	0	110,236	1,041,910
	TV		0	0	0	0	30,000	30,000
	Huamarrja		0	81,593	0	0	0	81,593
A.Shendetesise	Totali	3	20,000	2,000	0	0	0	22,000
73018	Granti	3	20,000	2,000				22,000
	TV							0
SHSH.Prim	Totali	101	705,000	256,267	30,000	0	140,236	1,131,503

73550	Granti	101	705,000	174,674	30,000		110,236	1,019,910
	TV						30,000	30,000
				81,593				81,593
SH Sociale	Totali	10	60,000	10,000	3,000	0	0	73,000
75540	Granti	10	60,000	10,000	3,000			73,000
	TV							0
Kultura	Totali	12	65,200	30,000	0	0	70,000	165,200
850-85009	Granti	12	65,200	30,000			40,000	135,200
	TV						30,000	30,000
Arsimi & Shken	Totali	518	2,817,546	281,641	34,000	0	248,447	3,381,634
	Granti	518	2,817,546	275,000	34,000	0	244,020	3,370,566
920	TV		0	0	0	0	0	0
	Huamarrja			6,641	0	0	4,427	11,068
A. Arsimit	Totali	8	51,769	35,000	0	0	0	86,769
92045	Granti	8	51,769	35,000				86,769
	TV							0
Ars.Parafillor	Totali	21	116,000	0	0	0	0	116,000
92370	Granti	21	116,000					116,000
	TV							0
A.Fillor	Totali	402	2,180,069	166,641	26,000	0	218,447	2,591,157
93240	Granti	402	2,180,069	160,000	26,000		214,020	2,580,089
	TV							0
	Huamarrj			6,641			4,427	11,068
A.Mesem	Totali	87	469,708	80,000	8,000	0	30,000	587,708
94441	Granti	87	469,708	80,000	8,000		30,000	587,708
	TV							0
	Totali	777	4,568,960	868,908	130,000	50,000	2,786,784	8,404,652
Totali	Granti	777	4,568,960	780,674	130,000	0	2,331,540	7,811,174
	TV		0	0	0	50,000	450,817	500,817
	Huamarrja		0	88,234	0		4,427	92,661